



|  |            |
|--|------------|
| <b>REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO</b><br><b>AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT</b><br><b>AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE</b><br><b>ANTI-CORRUPTION AGENCY</b> |            |
| Dep.   | 2-D/DPK    |
| Dep.   |            |
| Dep.   |            |
| Nr. I faq.   |            |
| Broj stranica  | 02         |
| Nr. pages  |            |
| Nr. Prot.  | 01-4721/15 |
| Br.Prot  |            |
| Prot No  |            |
| Data   |            |
| Datum  |            |
| Date   | 10.12.2015 |
| PRISHTINE  |            |



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (parografi 1.1), nenit 5 (parografi 1 pika 1.5), nenit 18 (parografi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenit 19 (parografi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 09.11.2015, mori:

### V E N D I M

**I. Mbylllet rasti me nr. AKK-03-02-2950/15, për zyrtarin e lartë z. Imer Reçica, Këshilltar Politik në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2950/15,që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Imer Reçica, Këshilltar Politik në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës (ZKM).**

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është konstatuar se zyrtari i lartë, z. Imer Reçica, Këshilltar Politik në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë ka të regjistruar një biznes privatë dhe figuron si pronar dhe person i autorizuar, në ketë biznes e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik andaj Agjencia kundër Korruptionit me datën 07.10.2015 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Imer Reçica, ka ardhur ne zyrat tona ku nga zyrtarët e AKK-së, është njoftuar për situatën ne të cilën gjendet.

z. Imer Reçica, është pajtuar me gjendjen, por është arsyetuar se nuk ka qenë në dijeni se kjo situatë është në kundërshtim me ligjin në fuqi, si dhe na ka njoftuar se biznesi në fjalë nuk ka zhvilluar aktivitet asnjëherë por vetëm është regjistruar ne ARBK dhe ka mbetur ashtu, por është zotuar se brenda afatit ligjor do të bez ndryshimet dhe do të veproj sipas ligjt në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Pas një kohe jemi njoftuar nga zyrtari Reçica, se ka filluar procedurat për shuarjen e këtij biznesi dhe ne momentin qe përfundojnë procedurat do ta njoftoj AKK-në me dokument zyrtar.

Agjencia kundër Korruptionit duke par se procedura po zvarritet nga zyrtari në fjalë i ka dërguar edhe një shkresë paralajmëruese për situatën në të cilën ndodhet.

Me datën 08.12.2015, kemi pranuar dokumentin zyrtar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se z. Imer Reçica, ka shuar biznesin me emër D.P.T-BUKI-M, dhe numër biznesi 70866250.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga z. Imer Reçica, Këshilltar Politik në Zyrën e Kryeministrat të Republikës së Kosovës, dukë bërë shuarjen vullnetare të biznesit, ku ka vepruar si person i autorizuar dhe pronar, janë krijuar rrëthana të reja andaj konsiderojmë se është shmangur gjendja e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Imer Reçica, Këshilltar Politik në Zyrën e Kryeministrat të Republikës së Kosovës, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrëthana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari kontaktues )

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

